TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 1196
Dt. 28.07.2025
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

HEKURUDHAT E KOSOVËS

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E RREZIQEVE

Korrik 2025

Në bazë të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A., në mbledhjen Nr. 25, të mbajtur më 28.07.2025, miraton këtë:

RREGULLORE
PËR MENAXHIMIN E RREZIQEVE NË HEKURUDHAT E KOSOVËS-TRAINKOS SH.A.

Përmbajtja:

1. Konteksti i Biznesit 5
- Konteksti i jashtëm 5
- Konteksti i brendshëm 5
- Kultura për menaxhimin e rrezikut 6
2. Qëllimi 6
3. Definicionet dhe qasja 6
4. Përkufizimet 7
5. Përgjegjësia 7
6. Procesi i menaxhimit të Rrezikut 8
A. Identifikimi i rreziqeve 9
B. Analiza e rrezikut 9
C. Vlerësimi i rrezikut 10
- Matrica e Rrezikut 10
- Gjasat për të ndodhur/Mundësia 11
- Ndikimi 11
D. Trajtimi i rrezikut 11
E. Komunikimi dhe konsultimi 12
- Funksionet dhe delegimet 13
F. Monitorimi dhe rishikimi 13

Shtojcë:

- Modeli i tabelës për rreziqe në HK-Trainkos Sh.A.
- Aneks 1. Formulari Standard për Vlerësimin e Rrezikut

Hyrje

Kjo rregullore synon, në masë praktikisht të arsyeshme, të siguroj që palët e interesit/palët e ndikuara, nuk rrezikojnë të ndikohen nga aktivitetet e ndërmarrjes ose edhe nëse ndikohen nga puna e kryer nga ndërmarrja, ajo siguron përmes qasjes parandaluese, mbrojtje nga incidente të pafavorshme, ose zvogëlon ekspozimin e tyre nga humbjet eventuale, dhe zbut dhe kontrollon rrezikun e humbjes nëse duhet të ndodhë.

Përmes zbatimit të politikës për menaxhimin e rrezikut, ndërmarrja synon të fuqizohet në vazhdimësi në rrugën e përmbushjes së misionit dhe objektivave të saj afatgjatë në krijimin dhe ruajtjen e vlerave, ndërkohë që kostot e rrezikut për ndërmarrjen dhe aksionarët/financuesit e saj, mbahen në minimumin e mundshëm.

Kjo procedurë, është bazuar në kërkesat ligjore të ligjit 06/L-021 për Kontrollin e brendshëm të Financave Publike, rregulloren e MF, Nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, ISO 31000: 2018, Get Through Guide: Qeverisja-Risku dhe Etika të përkthyer nga IKAF, si dhe CMA Guideline & Materials. Kjo rregullore krijon bazën e sjelljes dhe menaxhimit për grumbullimin e informatave të rëndësishme për identifikimin e rreziqeve, analizën dhe vlerësimin e tyre si dhe trajtimin përmes procedurave të njohura të trajtimit të rreziqeve. Po ashtu krijon bazën për monitorimin dhe komunikimin e rreziqeve të rëndësishme të ndërmarrjes dhe përmes tyre parandalimin ose trajtimin me kohë përmes vendimmarrjes adekuate, për të siguruar realizimin e objektivave afatgjatë.

1. Konteksti i Biznesit

HK-Trainkos Sh.A., është Shoqëri Aksionare dhe ofrues i të mirave publike, transportin e mallrave dhe udhëtarëve, nën rregullimin e saj si Ndërmarrje Publike e cila menaxhon mbi 150 punëtorë. Qëllimi i ndërmarrjes është ofrimi stabil i transportit. Për këtë, kjo politikë ka për qëllim të menaxhoj faktorët që ndikojnë në realizimin e këtij qëllimi dhe në vazhdimësinë e biznesit.

Aktivitetet parësore të ndërmarrjes janë: transporti i mallrave dhe transporti i udhëtarëve. Për të përmbushur këto dy funksione, HK-Trainkos Sh.A., është i organizuar në tri Departamente, Departamenti i Operimeve Hekurudhore, Departamenti i Administratës dhe Departamenti për Planifikim dhe zhvillim të Biznesit.

Konteksti i jashtëm

HK-Trainkos Sh.A., ofrimin e shërbimeve e ofrojnë me shumë vështirësi. Pengesë kryesore është mungesa e përkushtimit dhe mbështetjes financiare për zhvillim dhe investime nga faktori vendor. Transporti i udhëtarëve definohet me politikat shtetërore për trenat në qarkullim dhe mbështetja e këtyre trenave me Marrëveshjen OShP (Obligimi i Shërbimeve Publike). Transporti i mallrave përveç kapaciteteve në transport brenda vendit varet kryesisht në qasjen e rrjetit hekurudhor në Linjat hekurudhore të Evropës dhe Portet detare. Lidhja me Linjën e 10-të hekurudhore që kalon nga Maqedonia Veriore dhe Serbia mund të shfrytëzohet vetëm te Maqedonia Veriore pasi që nga viti 2008 nuk ka qarkullim nga pjesa Veriore e shtetit – Leshaku.

Gjithashtu humbja e tregut dhe kredibiliteti si rezultat i ngecjeve dhe jo seriozitetit në zbatimin e projekteve në modernizimin e linjave ekzistuese hekurudhore në vend, marrja e licencës dhe fillimi i operimit me trena të operatorit privat hekurudhor, mangësitë në Ligjin për Hekurudhat dhe mungesa e legjislacionit sekondar që duhet të avanconte transportin hekurudhor në vend, mos anëtarësimi në asociacione dhe institucione relevante ndërkombëtare dhe mungesa e Kodit Hekurudhor, mundësitë e transporteve konkurruese për të qenë fleksibil në aspektin e shpejtësisë, dërgesës, çmimit, etj.

Kostoja e lartë e investimeve në mjetet lëvizëse që kërkon angazhim dhe kujdes të veçantë dhe vazhdimësia e mungesës së mbështetjes financiare për zhvillimin e infrastrukturës dhe investimet në mjete të reja lëvizëse.

Konteksti i brendshëm

- HK-Trainkos Sh.A., ka pasur punësimin në fillimet e operimeve të veta dhe aktualisht mosha mesatare e punëtorëve është mjaft e shtyrë,
- Pajisjet e vjetruara teknologjike,
- Mungesa e stafit ekzekutiv,

2. Kultura për menaxhimin e rrezikut

Ndërmarrja nuk ka pasur një politikë të menaxhimit të rrezikut sipas qëllimit dhe funksionit të kësaj rregulloreje dhe si rrjedhojë nuk e ka të formësuar kulturën e menaxhimit të rrezikut. Prandaj, në vijim synohet të vendoset politika dhe procedura që ndikojnë në krijimin e kulturës organizative, për menaxhimin e rrezikut. Entreprise Risk Management Initiative Faculty e definon kulturën e rrezikut si "një sistem të vlerave dhe sjelljeve në një organizatë që formëson sjelljen vendimmarrëse të menaxhmentit dhe punëtorëve"[1]. Duke operuar në një treg të kufizuar të ofrimit të shërbimeve ku kërkesa e klientëve është për çmime më të lira në krahasim me transportin rrugor HK-Trainkos Sh.A., natyrën e rreziqeve e ka të ndërlidhur me krijimin, ruajtjen dhe ofrimin e çmimeve për ta mirëmbajtur stabilitetin e shërbimeve të ofruara. Në funksion të këtij qëllimi, aplikimi i një procedure për menaxhimin e rrezikut, inkurajon të menduarit afatgjatë dhe strategjik po ashtu i përgjigjet kërkesave ligjore, që dalin nga ligji për kontrollin e brendshëm të financave publike 06/L-21 dhe në udhëzimin administrativ 01/2019 për identifikimin dhe menaxhimin e rrezikut e cila ndikon në cilësinë e menaxhimit si dhe në garancinë për vazhdimësinë dhe realizimin e objektivave afatgjata të biznesit.

3. Qëllimi

Kjo politikë synon të krijoj procesin për administrimin e rreziqeve me të cilat përballet ndërmarrja. Qëllimi i menaxhimit të rrezikut është maksimizimi i mundësive në të gjitha aktivitetet e ndërmarrjes dhe të minimizojnë vështirësitë. Po ashtu, synon krijimin e një liste të rreziqeve përmes një procesi të mirë definuar për identifikimin e tyre, krijimin e teknikave për menaxhimin e rreziqeve dhe raportimin e tyre.

4. Definicionet dhe qasja

Sipas nenit 1.18 të ligjit 06/L-21, rreziku- nënkupton mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte në arritjen e objektivave të ndërmarrjes. Si e tillë, objektivat dhe qëllimet e një biznesi, projekti ose veprimtarie së pari duhet të identifikohen për të siguruar që të gjitha rreziqet e rëndësishme janë kuptuar. Kjo siguron që vendimet për menaxhimin e rrezikut të mbështesin gjithmonë arritjen e qëllimeve dhe objektivave më të gjera të biznesit. Kjo qasje inkurajon të menduarit afatgjatë dhe strategjik po ashtu i përgjigjet kërkesave ligjore, që dalin nga ligji për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe në udhëzimin administrativ 01/2019 për identifikimin dhe menaxhimin e rrezikut. Ligji kërkon që përmes krijimit të një kulture të etikës dhe profesionalizmit të vendosen kontrolle ex-ante (para ndodhjes) së ngjarjeve dhe ex-post (pas ndodhjes së ngjarjeve) për minimizimin e rreziqeve.

Sipas ISO 31000 "administrimi i rrezikut është një proces menaxhimi që stimulon realizimin me kosto efektive të objektivave të ndërmarrjeve, për më tepër standardi gjithashtu thotë që qëllimi i menaxhimit të rrezikut është krijimi dhe mbrojtja e vlerës".

5. Përkufizimet

Rreziku karakterizohet dhe vlerësohet duke marrë parasysh dy karakteristika:

a) Probabiliteti ose gjasat (L) e shfaqjes; dhe

b) Niveli kritik i rrezikut/Ndikimi (C) e shfaqjes. Kjo shprehet si R (rreziku) = L (gjasa) x C (ndikimi).

Gjasat janë një përshkrim cilësor i probabilitetit ose i frekuencës. Ndikimi është rezultati i një ngjarje, duke qenë një humbje, dëmtim, disavantazh ose fitim. Mund të ketë një gamë të rezultateve të mundshme që lidhen me një ngjarje. Kontrolli i rrezikut nënkupton marrjen e masave për të zvogëluar gjasat e ndodhjes së një rreziku në mënyrë të arsyeshme. Vlerësimi i rrezikut është procesi i vlerësimit dhe krahasimit të nivelit të rrezikut kundrejt objektivave të paracaktuara, në nivele të pranueshme të rrezikut. Menaxhimi i rrezikut është aplikimi i një sistemi menaxhimi ndaj rrezikut dhe përfshin identifikimin, analizën dhe vlerësimin, trajtimin, monitorimin dhe komunikimin e rreziqeve. Pronari i rrezikut është personi përgjegjës për administrimin e rreziqeve dhe zakonisht është personi drejtpërdrejt përgjegjës për strategjinë, aktivitetin ose funksionin që lidhet me rrezikun.

6. Përgjegjësia

Është përgjegjësi e të gjithë anëtarëve të Bordit, menaxhmentit dhe stafit të ndërmarrjes të identifikoj, të analizoj, vlerësoj, reagoj, monitoroj dhe komunikoj në mënyrë periodike rreziqet që lidhen me veprimtarinë, funksionin ose procesin e nën përgjegjësisë dhe autoritetit të tyre.

Përgjegjësia për koordinimin e procesit të menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjes bie mbi Zyrtarin Kryesor Financiar – ZKF , i cili i raporton Kryeshefit Ekzekutiv. Megjithatë pronar i rrezikut janë ata që zbatojnë procedurat ose ushtrojnë aktivitetet për trajtimin e rreziqeve.

Menaxhimi i rrezikut është njëri nga funksionet dhe ka një rol të fortë mbështetës në nivelin e bordit. Tani, bordi pritet gjithnjë e më shumë të ofrojnë një mbikëqyrje të fortë të menaxhimit të rrezikut. Kjo procedurë, siguron informacion të rëndësishëm për bordet, në mënyrë që ata të përcaktojnë dhe përmbushin përgjegjësitë e tyre për mbikëqyrjen e rrezikut. Në këtë kontekst, këto detyra mbikëqyrëse të Bordit përfshijnë: qeverisjen dhe kulturën, strategjinë dhe përcaktimin e objektivave, performancën, informimin, komunikimin, raportimin dhe rishikimin e praktikave për menaxhimin e rreziqeve për të përmirësuar performancën në krijimin dhe ruajtjen e vlerave në afatgjatë për organizatën. Auditimi i Brendshëm do të monitoroj periodikisht zbatimin e politikës së menaxhimit të rrezikut dhe do të raportoj sipas funksionit dhe përgjegjësive.

7. Procesi i menaxhimit të Rrezikut

Procesi i menaxhimit të rrezikut ka disa aktivitete kryesore në vartësi të kontekstit të biznesit. Grumbullimi i informatave për procesin e menaxhimit të rrezikut bëhet në formën e dhënë në Aneksin 1 të këtij dokumenti. HK-Trainkos Sh.A., ka adaptuar strukturën e menaxhimit të rreziqeve përmes skemës së mëposhtme e cila paraqet një cikël të vazhdueshëm dhe periodik të përsëritshëm të procesit të menaxhimit të rreziqeve. Ky proces ka 4 etapa kryesore për të menaxhuar rreziqet: identifikimin e rreziqeve, analizën e rreziqeve, vlerësimin e rreziqeve si dhe trajtimin e tyre.




Fig. 1. Procesi i menaxhimit të rrezikut në HK - Trainkos Sh.A.[2]

2 Përshtatur për HK-Trainkos Sh.A., sipas ISO 31000:2018

A. Identifikimi i rreziqeve

Ndërmarrja obligohet fillimisht të njoh rreziqet e mundshme që më pas të merret me to. Kjo arrihet përmes shtjellimit të situatave në nivele të ndryshme të vendimmarrjes ose zbatuese lidhur me atë se se çfarë mund të ndodh? Ku, kur dhe si mund të ndodh?

Ndërmarrja përgjithësisht përballet me disa lloje të rreziqeve të cilat sipas literaturës grupohen në:

a) **Rreziqet Strategjike si:** kultura dhe qeverisja korporative, planifikimi jo adekuat/ tejkalimi buxhetit, konkurrenca e jashtme, vendimmarrja për ndryshimet në politikën e çmimeve, transparenca dhe informimi i aksionarit, përgjegjësia shoqërore e ndërmarrjes etj. Niveli i vendimmarrjes është në nivel të Bordit.
b) **Rreziqet financiare** si: gjendja e përgjithshme ekonomike në vend, menaxhimi i të hyrave, likuiditeti/paraja e gatshme, detyrimet e trustit dhe ATK, detyrimet për llogari të pagueshme (furnitorët), raportimi dhe kontrolli financiar, çmimet e karburanteve, çmimet e qasjes në binarë, ndryshimet në legjislacion, ndryshimi në normat e interesit, etj. Niveli i vendimmarrjes është i menaxhmentit /Bordit.
c) **Rreziqet operative** si: probleme me mungesën e burimeve njerëzore (staf ekzekutiv) si dhe mosha mesatare e lartë e punëtorëve, dështime në realizimin e kontratave, vështirësi në gjetjen e pajisjeve për lokomotiva (pasi janë të vjetruara dhe nuk ka furnizime në vend), dëmet aksidentale, probleme në funksionimin e kontrolleve të brendshme, vjedhja dhe mashtrimet, etj. Niveli i vendimmarrjes është i menaxhmentit.
d) **Rreziqet e përputhshmërisë** si: detyrimet e drejtorëve dhe zyrtarëve lartë të ndërmarrjes, mbrojtja e shëndetit dhe siguria e punëtorëve, detyrimet për kontestet gjyqësore të trashëguara (dëmet, kontestet nga punëtorët etj.), rreziqet e katastrofave natyrore etj.

B. Analiza e rrezikut

Ndërmarrja duhet të analizojë secilin rrezik që është identifikuar në hapin e mëparshëm. Bazuar në nivelin e rrezikut që përcaktohet pas analizës së rrezikut, ndërmarrja është në gjendje të përcaktojë nëse rreziku është i pranueshëm apo jo. Kështu që, nëse rreziku rezulton i papranueshëm, ndërmarrja mund të ndërmarrë veprime për të modifikuar rrezikun që të korrespondojë me nivelin e pranueshëm të rrezikut.
Ndërmarrja do të përdorë një teknikë të aprovuar për të marrë parasysh pasojën dhe gjasat e secilit rrezik, dhe këto teknika mund të jenë cilësore, gjysmë-sasiore, sasiore ose një kombinim i tyre, bazuar në rrethanat dhe përdorimin e synuar.

C. Vlerësimi i rrezikut

Ky hap i ofron ndërmarrjes mundësinë që të ketë një mekanizëm që i ndihmon ata të rendisin rëndësinë relative të secilit rrezik, në mënyrë që të vendoset një përparësi trajtimi. Përpjekjet për përcaktimin kuantitativ të secilit rrezik duke u bazuar ne historikun e ngjarjeve do të ndihmojnë në menaxhimin adekuat të rreziqeve. Kjo procedurë kërkon që në të ardhmen të bëhen vlerësime adekuate kuantitative si dhe të krijohet një bazë e të dhënave për aktivitetet nën rrezik. Figura më poshtë përshkruan rangimin e rreziqeve sipas gjasave dhe ndikimit në pozicione të caktuara të hartës së rreziqeve duke dhënë sinjale për mënyrën e prioritizimit dhe reagimit sipas rrezikshmërisë.




Fig. 2. Vlerësimi i rrezikut sipas gjasave të ndodhjes dhe ndikimit që ka në biznes

Matrica e Rrezikut

Koncepti bazë i menaxhimit të rrezikut bazohet në principin se pa marrë parasysh natyrën dhe shkallën e rrezikut menaxhmenti ka për detyrë të zhvillojë metoda për eliminimin apo zvogëlimin e pasojave në një nivel të pranueshëm apo me ndikim minimal për operimet e ndërmarrjes. Matrica e rrezikut përshkruan në mënyrë figurative pozitën e rrezikut e me atë identifikon pronarët e funksionit të menaxhimit sipas departamentit përkatës. Për çdo rrezik i cili konsiderohet se klasifikohet mbi Mesatar si për nga Ndikimi ashtu edhe për nga Mundësia kërkon vëmendjen e udhëheqjes së departamentit përkatës. Nivelet më të ulëta të rrezikut mund të delegohen në nivele menaxheriale. Në anën tjetër, për çdo rrezik i cili konsiderohet se bie në nivelin katër (4) ose mbi të për nga ndikimi dhe mundësia kërkohet vëmendja e Drejtorit Menaxhues dhe raportime të rregullta tek Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes.

Gjasat për të ndodhur/Mundësia

Sipas të Gjitha Gjasave (5)– në këtë nivel vlerësohen ato rreziqe për të cilat udhëheqësit e departamenteve, apo zyrtarët tjerë në nivele më të ulëta, me saktësi mund të parashikojnë momentin e ngjarjes brenda periudhës së dokumentit si tërësi. Prej këndvështrimit Menaxhues drejtuesit konsiderojnë se në mendim të tyre çdo mundësi për parandalim është shterur dhe ka dështuar dhe se në kushtet aktuale nuk ekziston mundësi tjetër për parandalim apo eventualisht zvogëlim të pasojave në një nivel të pranueshëm.
I mundshëm (4)– pronari i rrezikut konsideron se gjasat për të ndodhur janë të mundshme brenda periudhës së dokumentit, por nuk mund të saktësoj momentin, apo edhe me saktësi nëse situata do të materializohet në periudhën e dokumentit. Gjithashtu, konsiderohet se ka ende mundësi për trajtim të mëtejshëm të rrezikut në një nivel më të favorshëm.
Mesatar (3) – rreziku konsiderohet se është i mundshëm për të ndodhur por konsiderohet i vështirë për të saktësuar nëse do të ndodhë gjatë periudhës së dokumentit. Si rrjedhojë pronari i rrezikut dhe drejtuesit e departamenteve kanë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të trajtuar situatën deri në një nivel të pranueshëm për ndërmarrjen.
Vështirë se (2) – pa marrë parasysh nivelin e ndikimit pronari i rrezikut konsideron se gjasat për të ndodhur skenari është i vështirë. Nuk mund te përcaktohet se do të ndodhe përgjatë periudhës së dokumentit apo edhe nëse do të ndodhë pas periudhës aktuale. Pronari i rrezikut dhe drejtuesit e departamenteve kanë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të trajtuar situatën deri në një nivel të papërfillshëm.
Rralle (1) – Gjasat për të ndodhur konsiderohen të rralla. Gjithashtu, menaxhmenti është i njohur me situatën dhe se ka kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të parandaluar dhe zvogëluar pasojat në nivel të pranueshëm apo edhe eliminuar në tërësi.

Ndikimi

Serioz/Fatal (5) – pasoja Serioze apo Fatale për operimet e ndërmarrjes.

Madhor (4) – probleme serioze në mbarëvajtjen e aktiviteteve të përditshme të ndërmarrjes**.** Drejtuesit e departamenteve janë të vetëdijshëm për situatën eventuale dhe se kanë planifikim rezervë dhe të aprovuar.
Mesatar (3) – çrregullime në mbarëvajtjen e aktivisteve për të cilat drejtuesit kanë planifikime paraprake për situatën e pritur.
I vogël (2) – pasoja të vogla, pa ndikim në operimet e përditshme të ndërmarrjes.

I papërfillshëm (1) – pasoja të papërfillshme për aktivitetet e ndërmarrjes.

D. Trajtimi i rrezikut

Menaxhimi i duhur i rrezikut kërkon vendime racionale dhe të informuara në lidhje me trajtimin e rrezikut. Në mënyrë tipike, trajtime të tilla përfshijnë: shmangien e veprimtarisë nga e cila buron rreziku, ndarjen e rrezikut, menaxhimin e rrezikut me anë të aplikimit të kontrolleve, pranimin e rrezikut dhe mos ndërmarrjen e ndonjë veprimi të mëtejshëm, ose marrjen e rrezikut dhe rritjen e rrezikut në mënyrë që të ndjekë një mundësi. Këto aktivitete për trajtim parashihen

në nenin 12 të ligjit për kontrollin dhe menaxhimin e brendshëm të financave publike.
Ndërmarrjet jo gjithmonë e gjejnë veten në telashe për shkak të sjelljes së tyre të tepruar dhe të pamatur. Ndonjëherë organizatat bien prapa konkurrencës së tyre si rezultat i ngurrimit të tyre për të ndërmarrë rreziqe dhe ndjekur mundësi. Trajtimi i rreziqeve përmes aktiviteteve për trajtim është dhënë në paraqitjen grafike/ harta e rreziqeve. Grafiku më poshtë sqaron masat që menaxhmenti duhet të ndërmarr në trajtimin e rreziqeve sipas kategorisë së rrezikut:



Fig. 3 Veprimet për trajtimin e rreziqeve

E. Komunikimi dhe konsultimi

Menaxhimi i duhur i rrezikut kërkon komunikim dhe konsultim të strukturuar dhe të vazhdueshëm me ata që preken nga operimet e ndërmarrjes. Komunikimi kërkon të promovojë vetëdijen dhe të kuptuarit e rrezikut dhe mënyrat për t'iu përgjigjur tij, ndërsa konsultimi përfshin marrjen e informatave kthyese dhe informacion për të mbështetur vendimmarrjen. Rezultatet e procesit të administrimit të rrezikut duhet të dokumentohen dhe raportohen përmes mekanizmave të duhur. Regjistrimi dhe raportimi është i rëndësishëm për arsye të tilla si komunikimi i aktiviteteve të menaxhimit të rrezikut dhe rezultatet që kanë të bëjnë me ato aktivitete në të gjithë organizatën dhe sigurimin e bazës dhe informacionit të nevojshëm për marrjen e vendimeve të informuara.

Funksionet dhe Delegimet

Për qëllime të menaxhimit të rrezikut nga menaxhimi i proceseve të brendshme dhe administrative, në përputhje me kërkesat e ligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike (06/L-021) ndërmarrja ka të vendosura procedurat strikte të kontrolleve të brendshme sipas kërkesës së nenit 13 të ligjit. Po ashtu kjo procedurë përcakton që:

- Një person mund të ketë më shumë se një detyrë dhe më shumë se një person mund ta ketë të njëjtën detyrë në të njëjtën kohë.
- Struktura organizative është e qartë dhe krijon mundësinë e monitorimit dhe raportimit vertikal si dhe nxit edhe komunikimin horizontal.
- Të drejtat dhe autorizimet jepen në bazë të përshkrimeve të vendeve të punës dhe gjithherë me shkresë zyrtare të arkivuar. Bartja e autorizimeve bëhet deri në nivele të tolerueshme me ligj, sipas detyrës dhe rëndësisë, për të lehtësuar proceset aty ku është e mundshme dhe ose për të shmangur konfliktin e interesit, etj.
- Në raste të parregullsive të ndryshme të cilat mund të vërehen në proces të menaxhimit të rreziqeve, udhëheqësi i SSP apo KE sipas skemës organizative të Trainkos Sh.A., do të veproj sipas ligjit 06/L-21 respektivisht nenit 32 – Procedura për raportimin e Parregullsive.

F. Monitorimi dhe rishikimi

Duke marrë parasysh që si ambienti i jashtëm ashtu edhe ai i brendshëm i nënshtrohen ndryshimeve të vazhdueshme, qëllimi i këtij hapi është të ndihmojë organizatat të sigurojnë dhe përmirësojnë cilësinë efektivitetin e procesit të administrimit të rrezikut. Monitorimi përfshin veprime të tilla si ekzaminimi i progresit të planeve të trajtimit, monitorimi i kontrolleve të vendosura dhe efektiviteti i tyre, sigurimi që aktivitetet të cilat janë të përshkruara janë shmangur, dhe kontrollimi se mjedisi nuk ka ndryshuar në një mënyrë që ndikon në rreziqe. Këto aktivitete do të jenë të koordinuara mes kërkesave të Bordit dhe aktiviteteve të rregullta të Auditimit të brendshëm.

Jetmir NUKA

Kryesues i Bordit të HK-Trainkos Sh.A.

Modeli i tabelës për rreziqe në HK-Trainkos Sh.A.:

						Palët e ndikuara									
Departamenti përgjegjës	**Nr.**	**Përshkrimi i aktivitetit (identifikimi i rreziqeve)**	**Niveli kritik i rrezikut/ndikimi**	**Probabiliteti i ndodhjes**	**Niveli i rrezikut**	**Personeli**	**Ndërmarrja**	**Kontraktorët**	**Publiku**	**Infrastruktura**	**Të tjera**	**Personi përgjegjës për menaxhimin e rrezikut**	**Lloji i rrezikut**	**Vlera**	**Masat për zvogëlimin e rrezikut**

ANEKS 1. FORMULARI STANDARD PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT

trainkos
Hekurudhat e Kosovës

Vlerësimi i Rrezikut

Forma Standarde për Departamentin

Përpiluesi:

Emiri i projektit, kodi i punës, data :

Departamenti përgjegjës
për aktivitetin :

Përshkrimi i aktivitetit (identifikimi i rrezikut) :

Palët e ndikuara :

☐	Personeli	☐	Publiku
☐	Ndërmarrja	☐	Infrastruktura
☐	Kontraktorët	☐	Të tjerët :

Përshkrimi i rrezikut	Mundësia (1-5)	Ndikimi (1-5)	Koeficienti (G*S)	Vlerësimi i rrezikut para marrjes së masave

Masat e rekomanduara :

Përshkrimi i rrezikut	Mundësia (1-5)	Ndikimi (1-5)	Koeficienti (G*S)	Vlerësimi i rrezikut pas marrjes së masave

Mundësia : Rrallë (1); Vështirë se (2); Mesatar (3); I mundshëm (4); Sipas të gjitha gjasave (5)
Ndikimi : Serioz /Fatal (5); Madhor (4); Mesatar (3); I vogël (2) ; I papërfillshëm (1)

Aprovimi nga Drejtori i Departamentit _____Data_____